
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 20.06.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE ORENDISH DHE PAJISJESH PËR MOBILIM PËR
PAVIONIN E POLIKLINIKËS SË SPITALIT SARANDË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Mobilje
39100000-3; Tavolina 39121200-8; Dollapë 39122100-4; Rafte 39141100-3; Karrige 39112000-0

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS: 1,465,483 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e
pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara,
ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari
përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbështetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c e 3 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Në nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar përcaktohet se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkojnë operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në

procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të

madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/c të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme);

ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme);

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm çertifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi, duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikujt e ofruar, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të mallrave sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët / skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

4. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor përfitues që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë ose montimi, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.

5. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër shërbimin e transportit dhe montimin e mallrave pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor përfitues brenda afatit të parashikuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin dhe vendosjen e tyre në gjendje të plotë përdorimi, në adresën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, të papërdorura dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara nga Organi Qendror Blerës të publikuara në faqen zyrtare të Operatorit Blerjeve të Përqendruara sh.a www.obp.al, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Karakteristikat teknike sipas Katalogut të OBP

Specifikimet teknike të përgjithshme të produkteve, kanë të përcaktuara karakteristikat e produktit, përshkrimin e produktit, kërkesat cilësore, sasiore, ambalazhimit, etiketimit.

Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim që të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë palët e interesuara.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Nr.	Emërtimi i artikujve	Përshkrimi i artikujve	Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi)	Foto/skica referuese	Njësia matëse
15	Dollap me dy kanata	Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm. Kanatet do të montohen me mentesha me thithje. Sergjenet do jenë prej materiali pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015	90 x 45 x 210 cm		Copë
62	Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik	Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali metalik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë metalik dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN			Copë

		1335-2:2018			
67	Stol pritje 3 vendësh, 2 vendësh, 1 vendësh	Materiali: Inoks. Ngjyra: Do të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor, Kapaciteti i mbajtës 325-350 kg. Pjesë të qëndrueshme me lidhje të salduara, gjë që rrit jetën dhe stabilitetin e stolit. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 12727:2016	Stoli 3 vendësh: Min 178x66x78cm Max 183x70x83cm Stoli 2 vendësh: Min 107x66x78 cm Max 115x70x83 cm; Stoli 1 vendësh: Min 50x66x78 cm Max 60x70x83cm.		Set
68	Shtrat vizite për infermierinë	Shtrati i vizitës do të ketë dimensione të përafërta 180cm x 60cm. Lartësia 75-80 cm. Sipërfaqja të jetë e përbërë nga një segment fiks dhe një segment me kënd të rregullueshëm. Pesha mbajtëse jo më pak se 100 kg. Skeleti do të ndërtohet me profil metalik tubolar me seksion katror 40 x 40 mm me spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5 mm. Elementët lidhës do të jenë profil tubolar me seksion 40 x 20 mm me spesor jo më të vogël se 1.5 mm. Si mbështetje do të kemi pllakë zdrukthi me trashësi 18 mm të veshur me sfungjer të cilësisë së lartë, e veshur me tekstil. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1725:2023	180 x 60 x 75-80 cm		Copë

70	Karrige statike pa krahë mbështetës	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësën. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me fushë elektrostetike. Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018			Copë
121	Tavolinë pune + Komodinë	Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe	Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi): 130 x 70 x 72 cm Komodinë me përmasa: 40 x 60 x h-68 cm		Set

		anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Komodina përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm, ngjyra të jetë e njëjtë me tavolinën. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)			
--	--	---	--	--	--

Shënim: Për çdo çertifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Operatori ekonomik fitues do të kryejë transportin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

NJËSIA E PROKURIMIT